

Kushtet e Përgjithshme të Urdhrit të Blerjes të DHL-së

1 Përkufizime

Në këto Kushte të Përgjithshme:

- 1.1 **“Kontrata”** është marrëveshja ndërmjet DHL-së dhe Furnitorit për furnizimin e Mallrave dhe/ose Shërbimeve, e cila përbëhet nga Urdhri përkatës i Blerjes, këto Kushte të Përgjithshme, çdo dokumentacion përkatës i procedurave të tenderimit në lidhje me Urdhrin e Blerjes, që është pranuar nga DHL-ja (sipas rastit), si dhe çdo Kontratë Kuadër.
- 1.2 **“Legjislacioni për Mbrojtjen e të Dhënave”** është i gjithë legjislacioni i zbatueshëm dhe kërkesat rregullatore që janë në fuqi kohë pas kohe dhe që zbatohen për një Palë lidhur me përdorimin e të dhënave personale (duke përfshirë privatësinë e komunikimeve elektronike).
- 1.3 **“DHL”** është subjekti i DHL-së i specifikuar në Urdhrin e Blerjes, i cili kontraktin në emër të vet dhe në emër të subjekteve të caktuara të DHL-së (të përcaktuara në vijim).
- 1.4 **“Subjektet e DHL-së”** janë DHL-ja dhe (për sa kohë që cilësohen si të tilla) të gjitha shoqëritë e tjera anëtare të DHL Group.
- 1.5 **“DHL Group”** është Deutsche Post AG, një shoqëri anonime gjermane me seli në Bonn, Gjermani, si dhe degët dhe filialet e saj.
- 1.6 **“Praktikë e industrisë e klasit të parë”** është ushtrimi i një shkalle aftësie, kujdesi, maturie dhe largpamësie që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga një lider i industrisë përkatëse në treg (lidhur me Furnitorin, Mallrat dhe/ose Shërbimet).
- 1.7 **“Ngjarje e Forcës Madhore”** është çdo ngjarje përtej kontrollit të arsyeshëm të një Pale, e cila përfshin, pa kufizim, forcat e natyrës, përmblytjet, shpërthimet, tërmetet, luftërat ose veprimet e tjera ushtarake, ndërprerjet e energjisë, trazirat civile, sulmet terroriste ose kryengritjet, duke përjashtuar pasojat e këtyre ngjarjeve që mund të shmangen nga Furnitori përmes zbatimit të një plani të arsyeshëm të vazhdimësisë së biznesit, si dhe mospërmblidhjen nga ana e një pale të tretë të detyrimeve të saj kundrejt Furnitorit.
- 1.8 **“Kontrata Kuadër”** është, sipas rastit, një kontratë e veçantë me shkrim që përfshin kushte të përgjithshme të dakordësuara dhe të nënshkruara nga DHL dhe Furnitori, objekti i së cilës mbulon Mallrat dhe/ose Shërbimet apo të cilën DHL e ka përfshirë në Urdhrin e Blerjes me anë të referencës.
- 1.9 **“Mallrat”** janë mallrat që DHL-ja ka kërkuar apo porositur nga Furnitori (nëse ka të tilla), të specifikuara në Kontratë.
- 1.10 **“Pala”** i referohet DHL-së ose Furnitorit, sipas kontekstit, ndërsa **“Palët”** i referohet bashkërisht DHL-së dhe Furnitorit.
- 1.11 **“Personeli”** përfshin stafin, konsulentët, punonjësit, agjentët dhe anëtarë të tjerë të personelit ose palë të treta (qoftë të përhershme apo të përkohshme) të Furnitorit, të përfshira në çfarëdo mënyre në furnizimin e Mallrave dhe/ose Shërbimeve nga Furnitori.
- 1.12 **“Urdhrat e Blerjes”** janë urdhrat e blerjes që DHL ka lëshuar për Furnitorin, të cilat specifikojnë Mallrat dhe/ose Shërbimet e kërkuara, të numërtuara zyrtarisht, dhe, sipas rastit, nëpërmjet sistemit të urdhrave të blerjes të DHL-së.
- 1.13 **“Numri i Urdhrit të Blerjes”** është numri i urdhrit të blerjes të DHL-së që citohet në Urdhrin e Blerjes.
- 1.14 **“Juridiksionet e Kufizuara”** janë vende, shtete, territore ose rajone që u nënshtrohen sanksioneve ekonomike ose kufizimeve tregtare gjithëpërfshirëse në bazë të ligjeve për tregtinë që zbatohen për Palët e Kontratës. Në kohën e fillimit të Kontratës, Juridiksionet e Kufizuara përfshijnë Bjellorusinë, Kubën, Gadishullin e Krimesë, zonat jo nën kontrollin e qeverisë të oblasteve ukrainase të Donetsk, Luhansk, Kherson dhe Zaporizhzhia, Iranin, Korenë e Veriut, Rusinë dhe Sirinë, dhe mund të pësojnë ndryshime.
- 1.15 **“Personat e Kufizuar”** janë të gjithë personat fizikë dhe juridikë (si p.sh. individët, shoqëritë, grupet, organizatat, institucionet) që janë:

(a) të listuar në një listë qeveritare të zbatueshme të palëve të ndaluara apo të kufizuara, duke përfshirë, por jo vetëm, versionet më të fundit të zbatueshme të Listës së Konsoliduar të Sanksioneve Financiare të Bashkimit Evropian (CFSL) dhe listat e zbatueshme të përfshira në Listën e Konsoliduar të Kontrollit të SHBA-së; apo në çdo listë kufizuese të ngjashme të personave në sanksionuar në bazë të ligjeve për tregtinë;

(b) drejtpërdrejt ose tërthorazi nën pronësinë, në shkallën 50% ose më shumë (përfshirë në total) apo nën kontrollin (sipas interpretimit të këtyre termave në bazë të ligjeve përkatëse për tregtinë) e një Personi të përshkruar në germën (a), apo që veprojnë në emër të një Personi të tillë; ose
(c) drejtorë, nëpunës apo punonjës të një Personi të përshkruar në germën (a) ose (b).

- 1.16 **“Shërbimet”** janë shërbimet që DHL ka kërkuar apo porositur nga Furnitori (nëse ka të tilla), të specifikuar në Kontratë.
- 1.17 **“Specifikimet”** janë përshkrimet, udhëzimet, dokumentet, planet, skicat, vizatimet, të dhënat teknike, kërkesat operative apo të gjitha kërkesat e tjera që lidhen me Mallrat dhe/ose Shërbimet, të rëna dakord midis Palëve dhe të parashikuara në këtë Kontratë.
- 1.18 **“Furnitori”** është kundërpala kontraktore e DHL-së, e përcaktuar në Urdhrin e Blerjes.
- 1.19 **“Kodi i Sjelljes për Furnitorët”** është Kodi i Sjelljes për Furnitorët (SCoC) i DHL-së, i cili është në fuqi në datën e Urdhrit të Blerjes.
- 1.20 **“Sistemet”** përfshijnë sistemin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të një Pale, duke përfshirë rrjetet, harduerin, softuerin dhe ndërfaqet e zotëruara apo të përdorura nga Pala apo nga agjentët ose kontraktorët e saj.
- 1.21 **“Kushtet e Përgjithshme”** janë kushtet e përgjithshme të shtjelluara në këtë dokument.
- 1.22 **“Ligjet për tregtinë”** janë të gjitha ligjet, rregulloret, dekretet, urdhëresat, urdhrat, politikat ose rregullat në lidhje me sanksionet ekonomike ose embargot, ligjet kundër bojkotit, listat e palëve të kufizuara, kontrollet tregtare mbi importin, eksportin, riekportin, transferimin apo format e tjera të tregtimit të mallrave, shërbimeve ose teknologjisë, si dhe të gjitha rregulloret, rregullat, kufizimet, urdhrat ose kërkesat e tjera të ngjashme që kanë fuqinë e ligjit në lidhje me çështjet e mësipërme dhe që janë në fuqi në çdo kohë, duke përfshirë ato të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të tij anëtare, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), apo të gjitha ligjet qeveritare që zbatohen për një Palë apo për Kontratën.

2 Marrëveshja e Blerjes

- 2.1 Në rastet kur gjen zbatim një Kontratë Kuadër, kushtet e kësaj Kontrate Kuadër kanë përparësi mbi këto Kushte të Përgjithshme për sa u përket Mallrave dhe/ose Shërbimeve.
- 2.2 Lëshimi i një Urdhri Blerjeje përfaqëson pëlqimin e DHL-së për të blerë Mallrat dhe/ose Shërbimet me çmimin e cituar në Urdhrin e Blerjes, sipas Kontratës. Gjithashtu, kur kjo është teknikisht e mundur në sajë të mjeteve të blerjes që përdor DHL-ja, Furnitori duhet të japë një konfirmim/pranim të Urdhrit të Blerjes.
- 2.3 Në përputhje me klauzolën 2.1, këto kushte të përgjithshme gjejnë zbatim për Kontratën duke përjashtuar të gjitha kushtet e tjera të përgjithshme që Furnitori synon të vendosë apo përfshijë, apo që mund të jenë të përfshira në mënyrë të nënkuptuar në ligj, në zakonet tregtare apo në praktikat apo rrjedhën e tregtisë.
- 2.4 Shtesat, ndryshimet, përjashtimet apo përjashtimet e synuara të ndonjë kushti të Kontratës, duke përfshirë Kushtet e Përgjithshme, nuk do të kenë efekt detyrues nëse nuk është dhënë pëlqimi me shkrim i një përfaqësuesi të autorizuar të DHL-së.
- 2.5 Asnjëra Palë nuk ka të drejtë të mbështetet mbi një marrëveshje, ujd apo rregull që nuk përbën shprehimisht pjesë të Kontratës, dhe kjo e fundit mund të ndryshohet vetëm me anë të një marrëveshjeje me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar rregullisht të të dyja Palëve.
- 2.6 Kontrata nuk i jep Furnitorit asnjë lloj ekskluziviteti.

3 Çmimet

- 3.1 Çmimet janë ato të dakordësuara nga Furnitori dhe DHL-ja dhe të parashikuara shprehimisht në Urdhrin e Blerjes, apo të dakordësuara ndryshe me shkrim midis Palëve. Ato janë çmime fikse dhe gjithëpërfshirëse. Çmimet e cituara mbulojnë të gjitha shpenzimet e kryera deri në përmbytjen e Kontratës (p.sh. paketimin, transportin, sigurimin, zhdoganimin, instalimin, të gjitha taksat dhe tatimet, kostot e udhëtimit dhe akomodimit dhe kostot e zyrave/administrative) si dhe të gjitha tarifatat që lidhen me Mallrat dhe/ose Shërbimet. Çmimet nuk përfshijnë taksat indirekte mbi mallrat dhe shërbimet (siç është TVSH-ja, Taksa për Mallrat dhe Shërbimet (GST), Taksa mbi Shitjet), me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë. DHL-ja nuk paguan asnjë shumë tjetër shtesë, me përjashtim të rasteve kur është dakordësuar ndryshe me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar i DHL-së.
- 3.2 Çmimi mbetet i pandryshuar për të gjithë kohëzgjatjen e Kontratës. Furnitorit nuk i lejohej të aplikojë përshtallëzime apo rritje të çmimit apo të tarifave të tjera pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim të DHL-së.
- 3.3 DHL ka të drejtën të përfitojë ulje për pagesa të menjëhershme, blerje në sasi të mëdha ose blerje në një vëllim të caktuar, ose ulje të tjera të ofruara zakonisht nga Furnitori në rrethana të tilla, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe me shkrim midis Furnitorit dhe DHL-së.

4 Specifikimet

- 4.1 Furnitori garanton dhe deklaron se Mallrat dhe/ose Shërbimet do të jenë në pajtim me Specifikimet dhe me të gjitha dispozitat e Kontratës për sa i përket cilësisë, sasisë dhe përshkrimit, do të jenë të përshtatshme për të gjitha qëllimet e specifikuar nga DHL, nuk do të kenë defekte materiale dhe defekte në prodhim, dhe do të përkojnë në të gjitha aspektet me kampionet ose modelet e ofruara nga Furnitori dhe të miratuara nga DHL, apo të ofruara nga DHL për Furnitorin. Ndryshimet e Specifikimeve nuk lejohen pa miratimin paraprak me shkrim të DHL-së.
- 4.2 Pa cenuar sa më lart, Furnitori pranon të ofrojë Mallrat dhe/ose Shërbimet të paktën në përputhje me Praktikën e Industrisë të Klasit të Parë, në mënyrë profesionale, pa vonesë dhe duke treguar të gjithë kujdesin dhe vigjilencën e duhur, me përfshirjen e personelit të kontrolluar, të kualifikuar dhe të trajnuar.
- 4.3 Furnitori garanton dhe deklaron se Mallrat dhe/ose Shërbimet do të jenë në çdo rast në pajtim me ligjet, standardet administrative, urdhrat dhe rregulloret e zbatueshme, duke përfshirë, pa kufizim, ato që lidhen me sigurinë, mjedisin, higjienën dhe materialet e rrezikshme, prodhimin, etiketimin, paketimin, ruajtjen, trajtimin dhe lëvrimin e Mallrave ose ofrimin e shërbimeve, ndër të cilat edhe ato të vendit të furnizimit dhe ofrimit (apo që i janë këshilluar Furnitorit nga DHL-ja), dhe se Furnitori do të veprojë në çdo rast në përputhje me to.
- 4.4 Furnitori garanton dhe deklaron se ka dhe do të ruajë të gjitha licencat dhe certifikatat e nevojshme për ofrimin e Mallrave dhe/ose Shërbimeve, dhe se do të paraqesë kopje të këtyre licencave dhe certifikatave me kërkesë të DHL-së.

5 Inspektimi dhe testimi

- 5.1 Furnitori lejon DHL-në të inspektojë dhe testojë Mallrat në çdo kohë gjatë prodhimit, përpunimit ose ruajtjes, si dhe të inspektojë performancën e Shërbimeve, qoftë në ambientet e Furnitorit apo të një pale të tretë, përpara dërgesës dhe në çdo rast mbi bazën e kërkesës. Furnitori ofron ose siguron të gjitha mjediset dhe lehtësitë e nevojshme që mund të kërkojnë nga DHL për këtë inspektim dhe testim. Me kërkesë të DHL-së, Furnitori siguron një kopje të noterizuar të dokumenteve përkatëse të testimit.
- 5.2 Në rast se, si rrjedhojë e këtij inspektimi dhe/ose testimi, DHL krijon bindjen se Mallrat dhe/ose Shërbimet nuk përputhen me Kontratën ose nuk ka gjasa të përputhen me të pas përfundimit të fazës së prodhimit, DHL njofton përkatësisht Furnitorin. Furnitori merr menjëherë hapat e nevojshëm për të garantuar pajtueshmëri të plotë me Kontratën, brenda afateve kohore të pranueshme nga DHL-ja dhe pa kosto shtesë për këtë të fundit. DHL ruan të drejtën për të vënë në zbatim secilin prej mjeteve të ankimit që ajo disponon në bazë të Kontratës apo të ligjit, dhe dispozitat e kësaj klauzole nuk përbëjnë në asnjë rrethanë heqje dorë nga kjo e drejtë.
- 5.3 Furnitori, me kërkesë të DHL-së, jep provat dhe/ose informacionet e kërkuara nga DHL-ja lidhur me Mallrat (duke përfshirë vendndodhjen aktuale të Mallrave, kushtet e prodhimit, vendin e origjinës dhe/ose përmbajtjen e Mallrave dhe/ose pjesët e tyre dhe/ose lëndët e para të përdorura në prodhimin e tyre).
- 5.4 Ky inspektim apo testim, ose e drejta për kryerjen e tyre DHL-ja, nuk përbën pranim apo miratim të Mallrave dhe/ose Shërbimeve nga ana e DHL-së.

6 Dorëzimi dhe paketimi

- 6.1 Dorëzimi i Mallrave dhe ofrimi i Shërbimeve bëhet në adresën e dorëzimit të DHL-së, të specifikuar në Urdhrin e Blerjes, brenda datës/datave të dakordësuara paraprakisht, gjatë orarit të zakonshëm të punës të DHL-së. Të gjitha tatimet, taksat dhe tarifat e dorëzimit do të paguhën nga Furnitori.
- 6.2 Në rast se nuk është caktuar asnjë datë specifike dorëzimi/ofrimi, Furnitori i jep DHL-së njoftim të arsyeshëm me shkrim lidhur me datën/datat e propozuara, për t'u miratuar nga DHL-ja.
- 6.3 DHL ka të drejtën të shtyjë datën e dorëzimit/ofrimit pa kosto shtesë për DHL-në. Zgjatjet e afatit të dorëzimit dhe/ose ofrimit që kërkojnë nga Furnitori bëhen në çdo rast vetëm me marrëveshje paraprake të shprehur me shkrim midis DHL-së dhe Furnitorit. Në rast të shtyrjes së dorëzimit të Mallrave, Furnitori i ruan Mallrat me paketim të përshtatshëm dhe të dallueshëm, në një vend të veçantë e të sigurt, dhe blen sigurimin përkatës për mbulimin e Mallrave. Çdo zgjatje e tillë e afatit lidhet vetëm me zgjatjen specifike në fjalë dhe nuk konsiderohet si heqje dorë nga të drejtat e DHL-së në bazë të Kontratës lidhur me dorëzimin dhe/ose ofrimin në datën/datat e rishikuara të dorëzimit dhe/ose ofrimit, siç është dakordësuar.
- 6.4 Afati i dorëzimit të Mallrave dhe/ose i kryerjes së Shërbimeve është thelbësor për Kontratën, edhe në rastet e zgjatjes së afateve sipas klauzolës 6.3.
- 6.5 Në rastin e refuzimit të një dorëzimi që nuk përputhet me Kontratën, kostot dhe rreziku i kthimit të tij mbulohen nga Furnitori. Në rast mospërputhjeje të Shërbimeve, Furnitori mbulon kostot e riorfrimit të tyre në mënyrën e duhur.

- 6.6 Numri i Urdhrit të Blerjes (dhe sipas rastit numri i Kontratës) dhe adresa e saktë e dorëzimit/ofrimit të Shërbimeve duhet të citohet në çdo dokumentacion, duke përfshirë korrespondencën. Të gjitha Mallrat e dërguara në adresën e saktë të dorëzimit duhet të shoqërohen me një dëftesë dorëzimi ku përcaktohet data e Urdhrit të Blerjes, Numri i Urdhrit të Blerjes, lloji dhe sasia e Mallrave (duke përfshirë numrin e kodit të Mallrave (sipas rastit)), udhëzimet e posaçme të ruajtjes (nëse ka të tilla) dhe, nëse Mallrat dorëzohen me këste, bilancin e pashlyer të Mallrave të mbetura për dorëzim. Furnitori i jep gjithashtu DHL-së të gjithë informacionin përkatës lidhur me paketimin, përdorimin, datën e skadimit dhe të gjitha informacionet apo udhëzimet e kërkuara ose të nevojshme në kohën e dorëzimit. Mallrat dhe paketimi i tyre duhet të kenë shenja paralajmëruese lehtësisht të dallueshme, të cilat identifikojnë çdo rrezik që lidhet me Mallrat dhe/ose metodën e shpaktimit. Mallrat që nuk shoqërohen me një dëftesë dorëzimi që përmban informacionin e kërkuar mund të refuzohen pa asnjë lloj penaliteti kundrejt DHL-së.
- 6.7 Furnitori i jep DHL-së në kohën e duhur çdo udhëzim ose informacion të nevojshëm për t'i mundësuar asaj të marrë në dorëzim Mallrat dhe/ose të përfitojë Shërbimet. Mosdhënia e këtyre udhëzimeve apo informacioneve i jep DHL-së të drejtën t'i refuzojë këto Mallra dhe/ose Shërbime pa asnjë lloj penaliteti kundrejt DHL-së.
- 6.8 Nëse Mallrat dhe/ose Shërbimet nuk furnizohen në përputhje me Kontratën, DHL ka të drejtën t'i refuzojë këto Mallra dhe/ose Shërbime sipas Kontratës. Në këto rrethana, pa asnjë kosto shtesë për DHL, kjo e fundit ka të drejtën të kryejë një ose disa prej veprimeve në vijim (sipas gjykimit të DHL):
- 6.8.1 t'i kërkojë Furnitorit të riparojë Mallrat përkatëse apo të furnizojë Mallra zëvendësuese ose të riofrojë Shërbimet, në mënyrë që të garantojë pajtueshmëri të plotë me Kontratën; ose
- 6.8.2 menjëherë pas marrjes së njoftimit, të zgjidhë Urdhrin e Blerjes dhe/ose Kontratën dhe të kërkojë rimbursim të të gjitha shumave që DHL i ka paguar Furnitorit në bazë të Urdhrit të Blerjes, si dhe të të gjitha humbjeve dhe kostove shtesë të pësuar; ose
- 6.8.3 të ushtrojë të drejtat e saj të tjera dhe mjetet e ankimit në përputhje me klauzolën 13.
- 6.9 Furnitori duhet t'i paketojë Mallrat në mënyrën e duhur për të garantuar transportimin dhe marrjen e tyre të sigurt në pikën e dorëzimit të DHL-së.
- 6.10 DHL nuk ka detyrimin t'i rikthejë Furnitorit materialet e paketimit, pavarësisht nëse Mallrat janë pranuar ose jo nga DHL. Megjithatë, sipas zgjedhjes së saj, DHL mund t'i kërkojë Furnitorit të rimarrë materialet e paketimit me shpenzimet e veta. Kostoja e materialeve të paketimit, duke përfshirë paletat, nuk do t'i ngarkohet DHL-së nëse kjo e fundit nuk ka rënë shprehimisht dakord për këtë.
- 6.11 Furnitori do t'i japë DHL-së të gjithë informacionin përkatës për t'u mundësuar të dyja Palëve të shkarkohen nga përgjegjësitë e tyre sipas legjislacionit të zbatueshëm në lidhje me riciklimin dhe rikuperimin e mbetjeve të paketimit dhe, mbi bazën e kërkesës, do të bashkëpunojë dhe koordinohet me DHL-në me qëllimin për të minimizuar nevojën për materiale paketimi të tepërta, të panevojshme apo shpërdoruese.

7 Pronësia dhe rreziku (Mallrat)

- 7.1 Pronësia mbi Mallrat do t'i kalojë DHL-së pasi ato t'i jenë dorëzuar dhe të jenë pranuar prej saj në përputhje me këto Kushte të Përgjithshme, me përjashtim të rastit kur për Mallrat janë kryer parapagime ose pagesa progresive përpara dorëzimit, rast në të cilin pronësia e tyre do t'i kalojë DHL-së në momentin e kryerjes së pagesës. Nëse pagesa kryhet përpara dorëzimit, Mallrat ruhen veçmas dhe në mënyrë të sigurt, si dhe shënohen qartë për t'u bërë të identifikueshme si pronë e DHL-së. Furnitori do të ndërmarrë të gjitha hapat e përshtatshme për të garantuar ruajtjen e tyre në mënyrë të sigurt dhe për t'i mbajtur Mallrat të lira nga çdo barrë, peng, detyrim apo e drejtë tjetër konfiskimi, dhe do ta dëmshpërblejë DHL-në plotësisht dhe në mënyrë efektive lidhur me çdo rast të tillë. Në çdo rast, kalimi i pronësisë nuk do të cenojë asnjë të drejtë refuzimi që mund t'i lindë DHL-së apo që DHL ka ose mund të ketë mbi bazën e Kontratës apo legjislacionit të zbatueshëm.
- 7.2 Në rastin kur DHL ka paguar plotësisht apo pjesërisht shumat që i detyrohet Furnitorit, dhe Mallrat (ose disa prej tyre) rezultojnë të ngarkuara me barrë, peng, detyrim apo një të drejtë tjetër konfiskimi, Furnitori pranon se të gjitha shumat e paguara do t'i rikthehen menjëherë DHL-së nga Furnitori.
- 7.3 Rreziku i dëmtimit ose humbjes së Mallrave të furnizuara merret përsipër nga DHL vetëm pas kryerjes së dorëzimit dhe pranimit në përputhje me Kontratën. Deri në kohën e kryerjes së dorëzimit, rreziku lidhur me Mallrat do të vazhdojë të merret përsipër nga Furnitori.
- 7.4 Gjatë kohës kur rreziku lidhur me Mallrat merret përsipër nga Furnitori, e deri në kohën e kryerjes me sukses të dorëzimit, Furnitori i siguron Mallrat në vlerën e tyre të plotë të zëvendësimit kundrejt të gjitha rreziqeve të dëmtimit ose humbjes, dhe kur pagesa është kryer dhe pronësia i ka kaluar DHL-së, Furnitori e kompenson DHL-në plotësisht për çdo humbje të tillë dhe çdo dëmtim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që mund të ndodhë.

8 Refuzimi

- 8.1 Pa cenuar të drejtat e saj sipas klauzolës 13, DHL mund t'i refuzojë Mallrat dhe/ose Shërbimet në çdo kohë nëse Furnitori nuk përmbush detyrimet e tij sipas Kontratës, si dhe mund të refuzojë të gjitha Mallrat e dorëzuara dhe që

kanë rezultuar me cilësi të dobët, me defekte, në mospërputhje me Specifikimin, ose përndryshe të papërshtatshme për qëllimin e përshkruar. Kjo e drejtë refuzimi shtrihet mbi tërësinë e një dërgese Mallrash ose një pjesë të saj, si dhe mbi tërësinë e objektit të Shërbimeve ose mbi një pjesë të tij. Për të shmangur çdo dyshim, nëse për një pjesë të kësaj dërgese/një pjesë të objektit të Shërbimeve konstatohet një papërshtatshmëri e tillë, DHL mund të refuzojë tërësinë e kësaj dërgese/këtyre Shërbimeve apo një pjesë të saj/tyre. Për më tepër, asgjë nuk e detyron DHL-në të pranojë ose të ruajë apo të paguajë për Mallrat dhe/ose Shërbimet që tejkalojnë sasinë e Mallrave dhe/ose Shërbimeve që duhet të furnizohen në bazë të Kontratës.

8.2 Nëse Mallrat refuzohen nga DHL për çfarëdolloj arsyeje, pronësia dhe rreziku lidhur me Mallrat e refuzuara i kalon sërish Furnitorit.

8.3 Marrësit përkatës të Mallrave dhe/ose Shërbimeve i lihet kohë e mjaftueshme për të shqyrtuar dhe pranuar ose refuzuar Mallrat dhe/ose Shërbimet. DHL nuk konsiderohet se i ka pranuar Mallrat deri sa t'i jetë lënë një kohë e mjaftueshme për t'i inspektuar ato pas dorëzimit ose, nëse më vonë, brenda një kohe të arsyeshme pasi të jenë shfaqur defektet e fshehura të Mallrave.

Afatet e pranimit zgjaten automatikisht për periudhat gjatë të cilave marrësi përkatës i Mallrave dhe/ose Shërbimeve nuk ka marrë të gjithë materialin apo dokumentacionin përkatës në lidhje me Mallrat dhe/ose Shërbimet, apo gjatë të cilave defektet apo të metat e Mallrave dhe/ose Shërbimeve po korrigjohen apo po bëhen përpjekje për t'i korrigjuar.

8.4 Të gjitha Mallrat e refuzuara nga DHL në përputhje me këtë klauzolë do të merren menjëherë nga Furnitori, me shpenzimet dhe nën përgjegjësinë e tij, në përputhje me udhëzimet e arsyeshme të DHL.

9 Faturimi dhe kushtet e pagesës

9.1 Furnitori ka të drejtën të faturojë DHL-në pas dorëzimit të duhur të Mallrave dhe/ose ofrimit të duhur të Shërbimeve, sipas rastit, përveçse nëse është rënë dakord ndryshe me shkrim nga DHL.

9.2 Furnitori ia dorëzon të gjitha faturat DHL-së në përputhje të plotë me sa vijon:

9.2.1 Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të përmbajnë informacionin e saktë në vijim:

- (i) Emrin e plotë të regjistruar të shoqërisë së Furnitorit, numrin e regjistrimit, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën e emailit (konfirmimi i kryerjes së pagesës do të dërgohet në këtë adresë emaili);
- (ii) adresën e dorëzimit/ofrimit të shërbimit të plotë të DHL-së, duke përfshirë emrin tregtar të shoqërisë, numrin e regjistrimit të shoqërisë dhe kodin postar (qendra dhe funksioni i kostove për DHL-në);
- (iii) numrin e faturës;
- (iv) datën e faturës;
- (v) numrin e llogarisë – numrin e llogarisë së DHL-së pranë Furnitorit;
- (vi) emrin e personit në pikën e DHL-së që porositi Mallrat/Shërbimet;
- (vii) metodën e blerjes (numri i Urdhrit të Blerjes, kërkesa për shërbim, karta Visa, referenca e flotës, urdhri i punëve etj.);
- (viii) përshkrimin e mallrave/shërbimeve të ofruara;
- (ix) vlerën neto;
- (x) vlerën e TVSH-së;
- (xi) vlerën totale;
- (xii) numrin e TVSH-së;
- (xiii) nëse nuk janë dhënë më parë, të dhënat bankare (në format IBAN/Swift në rastin e një biznesi ndërkombëtar);
- (xiv) çdo kërkesë tjetër sipas legjislacionit të zbatueshëm.

9.2.2 Paga do të kryhet vetëm me marrjen e një fature të saktë.

9.2.3 Të gjitha faturat duhet të paraqiten nga Furnitori brenda gjashtë (6) muajve nga data e marrjes së Mallrave dhe/ose Shërbimeve të duhura nga ose në emër të DHL-së, dhe të dërgohen në destinacionin e duhur të faturimit, të përcaktuar në Urdhrin e Blerjes. Nëse Furnitori nuk i paraqet faturat në përputhje me këtë klauzolë brenda kësaj periudhe gjashtë (6) mujore, në masën e lejuar nga legjislacioni i zbatueshëm, kjo do të rezultojë në heqjen dorë nga ana e Furnitorit nga e drejta e tij për të marrë pagesën nga DHL-ja për ofrimin e këtyre Mallrave dhe/ose Shërbimeve.

- 9.3 Me kushtin e marrjes në gjendje të kënaqshme dhe pranimit të Mallrave dhe/ose Shërbimeve, faturat paguhen deri në gjashtëdhjetë (60) ditë pas marrjes së një fature të saktë nga DHL (me përjashtim të rasteve kur legjislacioni i zbatueshëm kërkon një afat më të shkurtër pagese). Pagesa kryhet në monedhën e përcaktuar në Urdhrin e Blerjes.
- 9.4 Me kërkesë të DHL-së, Furnitori merr përsipër t'ia paraqesë faturat DHL-së në rrugë elektronike, pa asnjë kosto shtesë për DHL-në, përmes ofruesit palë të tretë të DHL-së. Furnitori vepron në përputhje me kërkesat e faturimit elektronik të DHL-së. Për rrjedhojë, Furnitori do të nënshkruajë veçmas një marrëveshje përkatëse të kostos zero me këtë ofrues palë të tretë.
- 9.5 DHL-ja ka të drejtën të kompensojë çdo shumë që i detyrohet Furnitorit duke e zbritur atë nga shumat që ky i fundit i detyrohet DHL-së, si dhe të mbajë pagesat (qoftë në bazë të Kontratës dhe/ose të çdo marrëveshjeje tjetër) për Mallrat dhe/ose Shërbimet që nuk janë ofruar në përputhje me Kontratën. Furnitorit nuk i lejohej të bëjë kompensim të shumave të arkëtueshme kundrejt DHL-së pa pëlqimin paraprak me shkrim të DHL-së.
- 9.6 Sipas rastit, tatimi mbi vlerën e shtuar dhe çdo taksë, tatim apo tarifë tjetër që aplikohet kohë pas kohe nga një qeveri apo autoritet tjetër, duhet të identifikohet veçmas në çdo faturë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse (dhe duhet të jepen të gjithë numrat dhe të dhënat përkatëse të tatimit mbi vlerën e shtuar).
- 9.7 Një kopje elektronike e faturave të përzgjedhura mund të kërkohej nga DHL-ja për qëllime auditimi dhe duhet të dërgohet brenda 24 orëve pas kërkesës. Furnitori mban regjistra dhe dokumentacione të plota dhe të sakta për të justifikuar shumat e pretenduara në çdo faturë. Këta regjistra i vihen në dispozicion DHL-së mbi bazën e kërkesës. Gjithashtu, regjistrat lidhur me DHL-në janë të hapur për auditim për një periudhë prej një (1) viti pas plotësimit ose (nëse më vonë) pas përfundimit ose zgjidhjes së Kontratës.
- 9.8 Nëse DHL kundërshton shumat e pasqyruara në një faturë, në varësi të legjislacionit të zbatueshëm, ajo mund ta mbajë të gjithë shumën që duhet paguar në bazë të asaj fature dhe do të njoftojë Furnitorin me shkrim për këtë kundërshtim, duke dhënë detaje të plota lidhur me kundërshtimin dhe shumën faktike që ajo, mbi bazën e mirëbesimit, pretendon se nuk ka detyrim ta paguajë.
- 9.9 Në rast se, përpos dispozitave të kësaj klauzole, Furnitori ndërmerr hapa për të rikuperuar shumat ose pagesat që mendon se i takojnë atij (duke përfshirë iniciimin e procedurave gjyqësore), pa plotësuar rreptësisht kërkesat e Kontratës, çdo humbje, kosto apo dëmtim (duke përfshirë tarifat ligjore dhe gjyqësore) i çfarëdolloj natyre, i pësuar nga ose për llogari të DHL-së, është përgjegjësi e Furnitorit, i cili dëmshpërblen DHL-në lidhur me to.
- 9.10 Kryerja e pagesës nga ana e DHL-së nuk nënkupton në asnjë mënyrë heqjen dorë nga të drejtat. Në rast se Furnitori ka faturuar shuma në kundërshtim me Kontratën, Furnitori duhet të njoftojë menjëherë DHL-në dhe t'i rikthejë asaj (në çdo rast menjëherë me marrjen e kërkesës) çdo shumë të paguar, me përjashtim të rastit kur është rënë dakord ndryshe.
- 9.11 Pagesa e faturave bëhet me transfertë elektronike te një llogari e caktuar me shkrim nga Furnitori, në monedhën e rënë dakord në Urdhrin e Blerjes.
- 9.12 Furnitori duhet të japë të dhënat e sakta të llogarisë bankare për të mundësuar kryerjen e pagesave nga DHL-ja, si dhe ta mbajë DHL-në të përditësuar për çdo ndryshim të mëpasshëm të të dhënave të tij bankare. Furnitori pranon se mosdhënia e të dhënave të sakta bankare mund të rezultojë në vonesë të pagesave. Kur DHL-së i kërkohej nga legjislacioni vendas që të paguajë tatime dhe taksa për llogari të Furnitorit, ky i fundit i jep DHL-së autorizimin për ta bërë këtë, si dhe për t'i rimarrë këto shuma nga Furnitori qoftë drejtpërdrejtë apo përmes zbritjes nga fatura e Furnitorit.

10 Garancitë dhe Dëmshpërblimet

- 10.1 Furnitori mban përgjegjësi, dëmshpërblen dhe mban DHL-në të padëmtuar, mbi bazën e kërkesës, kundër të gjitha pretendimeve, padive, detyrimeve, humbjeve, dëmtimeve, lëndimeve, kostove dhe shpenzimeve (duke përfshirë shpenzimet ligjore) të shkaktuara ndaj apo të pësura nga DHL apo nga çdo anëtar i grupit të DHL-së, ose nga çdo agjent, punonjës, përfutues, kontraktor ose nënkontraktor i DHL-së, që vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë ose lidhen me përmbushjen e Kontratës nga Furnitori, duke përfshirë të gjitha humbjet ose shpenzimet që burojnë nga një kërkesë, pretendim apo padi e një pale të tretë (duke përfshirë çdo pretendim për shkelje të të drejtave të palëve të treta) dhe/ose çdo keqinterpretim, pakujdesi, mashtrim, shkelje apo mospërmbushje të detyrimeve ligjore të Furnitorit apo të personelit të Furnitorit, dhe veçanërisht ato që vijnë si pasojë e apo lidhen me:
- 10.1.1 Shkeljen e një garancie apo zotimi nga ana e Furnitorit lidhur me Mallrat dhe/ose Shërbimet;
- 10.1.2 Çdo pretendim se Mallrat dhe/ose Shërbimet, apo përdorimi ose rishitja e tyre, shkelin një patentë, të drejtë autori, të drejtë dizajni, markë tregtare apo të drejtë tjetër të pronësisë intelektuale të një personi tjetër;
- 10.1.3 Çdo veprim apo mosveprim i Furnitorit apo personelit të tij në furnizimin, dorëzimin dhe instalimin e Mallrave;
- 10.1.4 Çdo veprim apo mosveprim i Furnitorit apo personelit të tij lidhur me ofrimin e Shërbimeve; dhe

- 10.1.5 Çdo lëndim apo humbje tjetër që i shkaktohet një punonjësi të DHL-së apo një personi tjetër në ambientet e DHL-së, si pasojë e fajit apo pakujdesisë së Furnitorit.
- 10.2 Furnitori vepron në përputhje me Kodin e Sjelljes për Furnitorët dhe me të gjitha politikat e DHL-së (të përditësuara herë pas here) që i jepen Furnitorit nga DHL-ja. Furnitori pranon të familjarizohet me këto politika, si dhe të informojë dhe t'i ofrojë trajnim të përshtatshëm Personelit të tij lidhur me përmbajtjen e tyre. Hyrja dhe/ose prania e Furnitorit në çdo vend pune të DHL-së i nënshtrohet kushteve të këtyre politikave.
- Krahas Kodit të Sjelljes për Furnitorët, zbatohen edhe sa më poshtë:
- 10.2.1 DHL-ja mund t'i përshtatë detyrimet e Furnitorit sipas Kodit të Sjelljes për Furnitorët në varësi të rezultateve të vlerësimit të rrezikut të kryer vazhdimisht nga DHL-ja. DHL-ja duhet të njoftojë Furnitorin për të gjitha detyrimet e nevojshme shtesë krahas atyre në Kodin e Sjelljes për Furnitorët të paktën një muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi. Me përjashtim të rastit kur DHL-ja merr një kundërshtim me shkrim nga Furnitori brenda 1 muaji pas marrjes së këtij njoftimi, këto ndryshime konsiderohen si të pranuar. DHL-ja ia cilëson specifikisht këtë pasojë Furnitorit me njoftimin e ndryshimeve.
- 10.2.2 Furnitori informon rregullisht DHL-në për të gjitha shkeljet dhe rreziqet e identifikuara në zinxhirin e vlerës të Furnitorit dhe për masat e marra në lidhje me to.
- 10.2.3 Furnitori u përcjell punonjësve të tij, në një mënyrë të përshtatshme, informacionin e marrë nga DHL-ja lidhur me aksesueshmërinë, përgjegjësinë dhe zbatimin e procedurës së DHL-së për ankesat. Procedura për ankesat duhet të jetë e aksesueshme për punonjësit, duke ruajtur fshehtësinë e identitetit dhe duke siguruar mbrojtje efektive nga hakmarrja.
- 10.3 Në lidhje me ofrimin e Mallrave dhe/ose Shërbimeve për DHL-në, Furnitori garanton dhe përfaqëson se:
- 10.3.1 ka dhe do të ketë kontroll të plotë mbi punësimin, menaxhimin, shpërblimin dhe shkarkimin e të gjithë Personelit të Furnitorit, dhe për këtë qëllim ka dhe do të ketë kontrata punësimi të vlefshme dhe në përputhje me legjislacionin e punës me të gjithë Personelin e Furnitorit, për të gjithë kohëzgjatjen e Kontratës;
- 10.3.2 do të jetë ekskluzivisht përgjegjës për të gjitha çështjet që lidhen me dhënien e pagave dhe shpërblimeve për të gjithë Personelin e Furnitorit, si dhe për pajtueshmërinë e duhur dhe të plotë me legjislacionin e punës, atë tatimor dhe të sigurimeve shoqërore, rregullat e lejes për të punuar, dhe kërkesat e shpërblimit dhe përfitimeve, duke përfshirë pagesën e plotë dhe në kohën e duhur të pagave të detyruara dhe zgjidhjen e të gjitha ankesave mbi bazën e të gjitha ligjeve të zbatueshme;
- 10.3.3 është plotësisht përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e Personelit të Furnitorit gjatë përmbushjes së detyrimeve të Furnitorit kundrejt DHL-së mbi bazën e Kontratës.
- 10.4 Moskryerja e pagesave apo kryerja e tyre me vonesë, mbajtja ose transferimi i pagave, tatimeve mbi pagat, tatimeve mbi xhiron, kontributeve të sigurimeve shoqërore ose kontributeve të sigurimit të punonjësve përbëjnë baza të vlefshme për zgjidhjen e Kontratës me shkrim nga ana e DHL-së, me efekt të menjëhershëm.
- 10.5 Deklaratat, garancitë, dëmshpërblimet dhe mjetet e ankimit që përmban kjo Kontratë u shtohen atyre të nënkuptuara nga ligji ose nga praktika (të cilat konsiderohen si pjesë e Kontratës).
- 10.6 Asnjëra prej Palëve nuk i përjashton përgjegjësitë e saj në një masë që do të konsiderohej si e jashtëligjshme ose e paligjshme.
- 10.7 Furnitori (a) do t'i akordojë DHL-së përfitimin e çdo garancie lidhur me Mallrat dhe/ose Shërbimet nga furnitorë palë të treta (qoftë përmes transferimit apo të dhënë drejtpërdrejt nga furnitorët palë të treta) ose (b) do t'i japë DHL-së të njëjtat garanci që Furnitori merr nga furnitorët palë të treta lidhur me Mallrat dhe/ose Shërbimet.

11 Besueshmëria e Furnitorit

- 11.1 Me kërkesë të DHL-së, Furnitori merr pjesë me shpenzimet e veta në një ekzaminim të tijin dhe/ose të Personelit të tij, duke përfshirë kryerjen e çdo kontrolli shtesë ose marrjen e çdo vërtetimi të sjelljes së mirë që DHL-ja mund të kërkojë.
- 11.2 Furnitori garanton dhe bie dakord se Personeli i përfshirë në përmbushjen e Kontratës do të respektojë Kodin e Sjelljes për Furnitorët.
- 11.3 Furnitori, me kërkesë të DHL-së dhe në shkallën e lejuar nga legjislacioni i zbatueshëm (për mbrojtjen e të dhënave), jep një specifikim të informacioneve personale përkatëse të Personelit të përfshirë në përmbushjen e Kontratës.
- 11.4 Furnitori, me kërkesë të DHL-së dhe me shpenzimet e veta, jep një vërtetim të sjelljes së mirë (ose një vërtetim të ngjashëm ligjor) të kohëve të fundit, lidhur me sjelljen e tij dhe/ose të Personelit të përfshirë në përmbushjen e Kontratës, në shkallën e lejuar nga legjislacioni i zbatueshëm. Kur kërkohet një vërtetim i tillë, ai duhet të jepet përpara ofrimit të Mallrave ose Shërbimeve sipas Kontratës.

- 11.5 Furnitori merr përsipër të përdorë vetëm Personel me formimin e duhur profesional dhe me aftësitë dhe ekspertizën e duhur për përmbushjen e Kontratës.

12 Sigurimi

Gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, Furnitori mban sigurim të përshtatshëm pranë një shoqërie sigurimi me reputacion të mirë, duke përfshirë sigurimin e përgjegjësisë profesionale, përgjegjësisë mbi produktet dhe përgjegjësisë publike (si dhe sigurimin e përgjegjësisë së punëdhënësit, të detyrueshëm sipas legjislacionit të zbatueshëm) për të mbuluar përgjegjësitë e tij që mund të lindin mbi bazën e Kontratës ose në lidhje me të, duke përfshirë të gjitha pretendimet për përgjegjësi që mund të lindin pas kohëzgjatjes së Kontratës. Me kërkesë të DHL-së, Furnitori paraqet certifikatën e sigurimit që përmban të dhënat e mbulimit me sigurim dhe faturën për primin e vitit aktual lidhur me çdo sigurim.

13 Mospërmbushja

- 13.1 Në rast se Furnitori nuk përmbush detyrimet e tij sipas Kontratës (pavarësisht faktit nëse Mallrat dhe/ose Shërbimet janë pranuar apo refuzuar nga DHL-ja), DHL-ja mund të ndërmarrë menjëherë një ose disa prej veprimeve në vijim:

- 13.1.1 të pezullojë shlyerjen e të gjitha faturave të Furnitorit apo të një pjese të tyre;
- 13.1.2 të rikuperojë dëmet dhe çdo kosto shtesë që buron nga mospërmbushja e ndonjë prej kërkesave të përcaktuara në Kontratë;
- 13.1.3 të rikthejë Mallrat me të meta ose defekte, me shpenzimet dhe nën përgjegjësinë e Furnitorit, në përputhje me dispozitat e klauzolës 6.8, rast në të cilin Furnitori do të rimbursojë çmimin e plotë të blerjes së këtyre Mallrave;
- 13.1.4 të rikthejë Mallrat me të meta ose defekte për riparim ose zëvendësim nga Furnitori, me shpenzimet dhe nën përgjegjësinë e këtij të fundit, në përputhje me Klauzolën 6.8 (sipas gjyqimit të DHL-së). Ky riparim apo zëvendësim duhet të kryhet brenda shtatë (7) ditëve pas njoftimit të tyre te Furnitori;
- 13.1.5 të riparojë Mallrat me të meta ose defekte me shpenzimet e Furnitorit;
- 13.1.6 të riofrojë Shërbimet me të meta me shpenzimet e Furnitorit;
- 13.1.7 të zëvendësojë Mallrat dhe/ose Shërbimet me të meta ose defekte me mallra dhe/ose shërbime të barasvlershme të blera nga një burim alternativ. Çdo kosto shtesë e pësuar nga DHL-ja për shkak të marrjes së këtyre mallrave dhe/ose shërbimeve nga burime alternative do të mbulohet nga Furnitori; dhe
- 13.1.8 të zgjidhë Kontratën në përputhje me Klauzolën 16.

- 13.2 Mjetet e ankimit të renditura në Klauzolën 13.1 nuk cenojnë të drejtat apo mjetet e tjera të ankimit që mund të gëzojë DHL-ja.

- 13.3 DHL-ja nuk mban përgjegjësi përpara Furnitorit dhe nuk është përgjegjëse për mosfurnizimin e Mallrave ose moskryerjen e Shërbimeve si pasojë e një defekti, avarie apo papërshtatshmërie në Sistemet e Furnitorit. Furnitori dëmshpërblen DHL-në për çdo humbje, detyrim dhe kosto apo shpenzim të tepërt të DHL-së që ka ardhur si pasojë e një avarie dhe/ose defekti në Sistemet e Furnitorit apo si pasojë e një virusi të transferuar nga ato te Sistemet e DHL-së.

14 Të Drejtat e Pronësisë Industriale dhe Intelektuale

- 14.1 Furnitori garanton që asnjë nga Mallrat dhe/ose Shërbimet e dorëzuara të mos jetë objekt i të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale të palëve të treta, apo që të jenë marrë licencat e nevojshme. Furnitori njofton DHL-në dhe e dëmshpërblen atë lidhur me çdo pretendim, padi, detyrim, humbje, dëmtim, lëndim, kosto dhe shpenzim (duke përfshirë shpenzimet ligjore) që rezulton nga një veprim apo shkelje e pretenduar e të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale, dhe realizon mbrojtjen me shpenzimet e tij ose (sipas zgjedhjes së DHL-së) asiston në realizimin e mbrojtjes në procedurat që mund të iniciohen kundër DHL-së nga një palë e tretë si pasojë e përdorimit të Mallrave dhe/ose Shërbimeve.

- 14.2 Të gjitha të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale të krijuara gjatë përmbushjes së Kontratës i akordohen dhe i takojnë në mënyrë të parevokueshme DHL-së. Furnitori pranon se të gjitha të drejtat e tilla të pronësisë industriale dhe intelektuale i akordohen DHL-së në mënyrë absolute, të parevokueshme dhe ekskluzive, në momentin e krijimit të këtyre të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale. Furnitori pranon të kryejë të gjitha veprimet dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet e nevojshme për t'u dhënë efekt dispozitave të kësaj klauzole 14.2.

- 14.3 Nëse ofrimi i Mallrave dhe/ose Shërbimeve përfshin dhënien e të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale dhe/ose të drejtave të tjera (të ngjashme) që i takojnë Furnitorit ose licencuesve të tij, Furnitori i jep DHL-së një (nën)licencë pa pagesë, joekskluzive, mbarëbotërore, të pakufizuar, të transferueshme, të parevokueshme dhe të

përhershme të këtyre të drejtave të pronësisë industriale dhe intelektuale, për qëllime të marrjes dhe përdorimit të Mallrave dhe/ose Shërbimeve.

- 14.4 Furnitori nuk përdor pronësinë intelektuale të DHL-së (emrin, logon, markën tregtare ose informacione të tjera pronësore) apo ato të klientëve të tij për çfarëdoqëllimi, duke përfshirë, por pa kufizim, reklamimin ose publicitetin, pa miratimin paraprak të shprehur me shkrim të DHL-së.

15 Transferimi dhe Nënkontraktimi

- 15.1 Furnitori nuk transferon, hipotekon, barrëson, nënkontrakton, delegon, deklaron një trust apo tregton në çfarëdoqëllimi mënyrë tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim të DHL-së, të drejtat dhe detyrimet e tij në bazë të Kontratës, sipas legjislacionit për kontratat dhe/ose atij të pronësisë, qoftë sipas ligjit apo praktikës. DHL mundet në çdo kohë të transferojë, hipotekojë, barrësojë, nënkontrakttojë, deklarojë një trust apo tregtojë në çfarëdoqëllimi mënyrë tjetër të drejtat dhe detyrimet e saj në bazë të Kontratës, sipas legjislacionit kontraktual dhe/ose atij të pronësisë, sipas ligjit ose praktikës.
- 15.2 Furnitori mund t'i nënkontrakttojë detyrimet e tij në bazë të Kontratës vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të DHL-së. Pëlqimi i dhënë nga DHL-ja nuk e shkarkon Furnitorin nga detyrimet dhe përgjegjësitë e tij, dhe Furnitori mbetet përgjegjës kryesor për përmbushjen e Kontratës. Furnitori garanton që nënkontraktorët të përzgjidhen dhe menaxhohen me kujdes, që nënkontraktorët të jenë kompetentë dhe që përmbushja e Kontratës të kryhet në mënyrën e duhur në përputhje me Praktikën e Industrisë të Klasit të Parë.

16 Zgjidhja

- 16.1 Pa cenuar të drejtat dhe mjetet e tjera të ankimit që ajo mund të gëzojë në bazë të ligjeve të zbatueshme, secila Palë ka të drejtën ta zgjidhë Kontratën ose çdo Urdhër Blerjeje plotësisht apo pjesërisht, pa mbajtur përgjegjësi për këtë zgjidhje, menjëherë pasi t'i ketë dhënë njoftim me shkrim Palës tjetër në çdo kohë, nëse:
- 16.1.1 Pala tjetër lidh një marrëveshje vullnetare me kreditorët e saj ose (nëse është shoqëri tregtare) i nënshtrohet një urdhri administrimi ose procedurave të likuidimit (për qëllime të ndryshme nga shkrirja ose ristrukturimi për qëllime të paaftësisë paguese), në çdo rast në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për paaftësinë paguese;
- 16.1.2 një barrësues merr në posedim sipërmarrjen, të ardhurat, pronën apo asetet e Palës tjetër, ose për to është caktuar një kujdestar, menaxher, administrator apo kujdestar administrues;
- 16.1.3 Pala tjetër resht apo ka rrezik të reshtë së vazhduari biznesin; ose
- 16.1.4 periudha e një Ngjarjeje të Forcës Madhore të njoftuar në bazë të klauzolës 17 ka zgjatur më shumë se 30 ditë.
- 16.2 Kushtet e përfshira në klauzolën 16.1 nuk janë shteruese dhe secila Palë mund të ketë të drejtën ta zgjidhë Kontratën apo çdo Urdhër Blerjeje edhe mbi bazën e kushteve të tjera të ngjashme apo analoge që mund të kenë të bëjnë me Palën tjetër.
- 16.3 DHL-ja mund ta anulojë Kontratën apo çdo Urdhër Blerjeje pa asnjë farë përgjegjësie kundrejt Furnitorit, në çdo kohë përpara nisjes së përmbushjes nga Furnitori, duke i dhënë këtij të fundit njoftim me shkrim.
- 16.4 DHL may terminate the Contract or any Purchase Order in whole or in part at any time and for convenience without any liability to DHL by giving not less than 30 days' notice to the Supplier.
- 16.5 Pavarësisht të drejtave apo mjeteve të tjera të ankimit që DHL mund të gëzojë në bazë të Kontratës apo legjislacionit të zbatueshëm, DHL ruan në çdo kohë të drejtën për ta zgjidhur menjëherë Kontratën apo çdo Urdhër Blerjeje, plotësisht apo pjesërisht dhe pa asnjë farë përgjegjësie, duke njoftuar Furnitorin me shkrim:
- 16.5.1 nëse Furnitori kryen një shkelje thelbësore ose shkelje të vazhdueshme (qoftë thelbësore ose jo) të ndonjë prej kushteve të Kontratës ose të një Urdhri Blerjeje;
- 16.5.2 nëse Furnitori kryen një shkelje të Kontratës ose të një Urdhri Blerjeje, e cila nuk është korrigjuar në një mënyrë që konsiderohet si e pranueshme nga DHL-ja brenda 14 ditëve nga dhënia e njoftimit nga DHL-ja për të kërkuar korrigjimin e shkeljes, me përjashtim të rastit kur dispozitat e Kontratës parashikojnë një afat më të shkurtër;
- 16.5.3 kur Furnitori nuk ka respektuar dispozitat e Kodit të Sjelljes për Furnitorët apo ndonjë prej politikave të tjera të përmendura në klauzolën 10.2;
- 16.5.4 nëse ka ndodhur një ndryshim në kontrollin apo pronësinë e Furnitorit apo të biznesit të tij, ose një pjesë e biznesit të tij i është shitur një pale të tretë; ose
- 16.5.5 DHL-ja konstaton se Furnitori ka pësuar një përkeqësim të ndjeshëm të rrethanave të tij financiare, gjë që mund të cenojë aftësinë e tij për të përmbushur Kontratën.

- 16.6 Furnitori nuk ka të drejtë të pretendojë zhdëmtim ose dëmshpërblim për zgjidhjen e Kontratës nën rrethanat e lartpërmendura. Shumat e parapaguara nga DHL-ja për Mallrat dhe/ose Shërbimet e paofuara ende në datën e zgjidhjes rimburohen në mënyrë të menjëhershme nga Furnitori.
- 16.7 DHL-ja nuk mban asnjë lloj përgjegjësie ndaj Furnitorit, me përjashtim të përgjegjësisë që lidhet me pagesën e tarifave që burojnë nga kjo Kontratë, dhe DHL-ja nuk mban në asnjë rast përgjegjësi ndaj Furnitorit për humbjen e fitimeve (qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, dhe qoftë faktike apo të parashikuar) ose për çdo humbje të drejtpërdrejtë ose shkakësore.
- 16.8 Përfundimi ose zgjidhja e Kontratës apo e një Urdhri Blerjeje për çfarëdolloj shkak nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e secilës Palë që kanë lindur përpara përfundimit apo zgjidhjes.
- 16.9 Dispozitat e Kontratës që vazhdojnë të zbatohen shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar pas përfundimit apo zgjidhjes, dhe veçanërisht dispozitat në lidhje me të drejtat e pronësisë intelektuale, konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave, konkurrencën, dëmshpërblimin dhe legjislacionin dhe juridiksionin rregullues, do të vazhdojnë të jenë të zbatueshme pavarësisht përfundimit apo zgjidhjes.

17 Forca Madhore

- 17.1 Asnjëra prej Palëve nuk mban përgjegjësi për përmbushjen me vonesë apo mospërmbushjen e detyrimeve të saj në bazë të Kontratës, nëse kjo vonesë apo mospërmbushje ka ardhur si pasojë e një Ngjarjeje të Forcës Madhore.
- 17.2 Nëse Furnitori nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij në bazë të Kontratës si pasojë e drejtpërdrejtë e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, Furnitori i jep njoftim me shkrim DHL-së duke cituar shkakun përkatës, dhe klauzola 17.1 fillon të zbatohet duke filluar nga data e këtij njoftimi.
- 17.3 Përmbushja e detyrimeve dhe kryerja e pagesave nga Palët në bazë të Kontratës pezullohet gjatë periudhës së Ngjarjes së Forcës Madhore. Menjëherë pasi Ngjarja e Forcës Madhore resht së ekzistuari, Pala e prekur prej saj njofton Palën tjetër me shkrim.
- 17.4 Në çdo kohë gjatë afatit të Kontratës, Furnitori mban në fuqi masa për rikuperimin pas fatkeqësive, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për të mundësuar rifillimin e furnizimit të Mallrave dhe ofrimit të plotë të Shërbimeve brenda periudhave të përcaktuara në planin e tij të rikuperimit pas fatkeqësive (një kopje e të cilit i vihet në dispozicion DHL-së mbi bazën e kërkesës).

18 Favorizimet dhe Konfliktet e Interesit

- 18.1 Furnitori nuk i ofron punonjësve të DHL-së apo përfaqësuesve të saj asnjë dhuratë, pagesë, favorizim, shpërblim ose tolerim lidhur me marrjen ose përmbushjen e Kontratës apo të një Urdhri Blerjeje, ose të një kontrate apo marrëveshjeje tjetër ndërmjet DHL-së dhe Furnitorit.
- 18.2 Furnitori i deklaron DHL-së çdo marrëdhënie që ka me stafin e DHL-së që mund të jetë i përfshirë në procesin e prokurimit apo përzgjedhjes së Furnitorit, dhe në çdo rast i deklaron DHL-së çdo konflikt interesi që mund të ketë me këtë të fundit. Mosdeklarimi i menjëhershëm i këtyre marrëdhënieve apo konflikteve të interesit konsiderohet si shkelje nga Furnitori.
- 18.3 Brenda dijenive dhe bindjeve të tij, as Furnitori dhe as filialet e tij (i) nuk janë shpallur asnjëherë nga një gjykatë apo juridiksion si të përfshirë në veprime korruptive (apo sjellje të ngjashme), (ii) nuk kanë pranuar në asnjë rast se janë përfshirë në veprime korruptive (apo sjellje të ngjashme), ose (iii) nuk kanë qenë asnjëherë nën hetim apo të dyshuar në ndonjë juridiksion për përfshirje në veprime korruptive (ose sjellje të ngjashme).

19 Konfidencialiteti

- 19.1 Furnitori mban të fshehtë dhe konfidencial të gjithë informacionin dhe njohuritë që i janë dhënë nga DHL (e cila, në këtë kontekst, do të përfshijë subjektet e DHL-së, klientët dhe furnitorët e saj) ose që lidhen me biznesin e DHL-së (e cila, në këtë kontekst, do të përfshijë subjektet e DHL-së, klientët dhe furnitorët e saj), dhe për të cilat Furnitori vihet në dijeni gjatë kohëzgjatjes së Kontratës apo si rrjedhojë e ofrimit të Mallrave dhe/ose Shërbimeve (si dhe siguron që ky detyrim të zbatohet dhe për Personelin e tij) dhe nuk ia jep këto informacione askujt, me përjashtim të rasteve kur dhënia e tyre autorizohet shprehimisht me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar i DHL-së.
- 19.2 Pa cenuar klauzolën 19.1 më lart, Furnitori merr përsipër t'ia japë informacionet konfidenciale apo njohuritë që i janë dhënë Furnitorit nga DHL-ja vetëm atyre anëtarëve të Personelit të Furnitorit që kanë një nevojë të arsyeshme për ta parë dhe përdorur atë për përmbushjen e Kontratës, si dhe ta përdorë këtë informacion vetëm për qëllimet e Kontratës.
- 19.3 Me përfundimin apo zgjidhjen e Kontratës, Furnitori, në varësi të detyrimeve ligjore të ruajtjes dhe me kërkesë të DHL-së, dorëzon ose shkatërron çdo dokument, të dhënë informacion dhe material tjetër nën posedimin, kujdesin apo kontrollin e tij, që mbart apo përfshin informacione konfidenciale apo njohuri që lidhen me biznesin e DHL-së (e cila, në këtë kontekst, do të përfshijë Subjektet e DHL-së, klientët dhe furnitorët e saj).

- 19.4 Furnitori informon të gjitha palët e treta që ai përfshin lidhur me detyrimin e tyre për të përmbushur detyrimet e konfidencialitetit që përmban kjo Kontratë. Me kërkesë të DHL-së, Furnitori siguron prova të përmbushjes së këtij detyrimi.
- 19.5 Detyrimi i konfidencialitetit që përmban klauzola 19.1 nuk zbatohet ose (sipas rastit) resht së u zbatuari (ose në rastin e klauzolës 19.5.2 resht përkohësisht së u zbatuari gjatë periudhës kur kërkohet dhënia e informacionit dhe vetëm për qëllimet e klauzolës 19.5.2) për informacione apo njohuri të cilat:
- 19.5.1 në kohën e dhënies së tyre nga DHL-ja, janë tashmë pjesë e domenit publik ose bëhen më pas pjesë e domenit publik, në mënyra të ndryshme nga shkelja e kushteve të Kontratës nga Furnitori; ose
- 19.5.2 duhet të jepen në bazë të kërkesave të ligjeve apo rregulloreve të zbatueshme, apo në bazë të urdhrit të një gjykate me juridiksion kompetent, apo të një departamenti apo agjencie qeveritare, me kusht që, përpara dhënies së tyre, Furnitori të informojë DHL-në lidhur me formën e propozuar të dhënies.
- 19.6 Furnitori nuk bën shpallje publike lidhur me marrëveshjet e bëra mes Palëve; nuk bën publike në asnjë lloj mënyre Kontratën, Urdhrat e Blerjes apo pjesë të tyre; nuk përmend rolin e tij në bazë të Kontratës apo në bazë të çdo Urdhri Blerjeje në materiale apo prezantime tregtare të çfarëdo lloji; ose nuk përdor logot apo markat tregtare të DHL-së pa pëlqimin paraprak me shkrim të DHL-së, të cilin DHL-ja mund të refuzojë ta japë nëse e vlerëson të arsyeshme mbi bazën e gjykimit të saj absolut. Teksti i çdo komunikimi të jashtëm që do t'u dërgohet palëve të treta lidhur me objektin e Kontratës kërkon miratimin paraprak me shkrim të DHL-së.

20 Të ndryshme

- 20.1 Kontrata përbën tërësinë e marrëveshjes dhe mirëkuptimit mes Palëve dhe ka përparësi ndaj çdo marrëveshjeje, mirëkuptimi apo ujdje të mëparshme midis tyre, qoftë me shkrim apo me gojë, që lidhet me objektin e Kontratës dhe që nuk është e përfshirë në këtë Kontratë.
- 20.2 Asnjë ndryshim i Kontratës, Specifikimeve, çmimeve, uljeve, zbritjeve, kushteve të pagesës apo çdo çështjeje tjetër që lidhet me Mallrat dhe/ose Shërbimet nuk do të pranohet nga DHL-ja gjatë afatit të Kontratës, me përjashtim të ndryshimeve të negociuara dhe të rëna dakord me shkrim nga DHL-ja.
- 20.3 Paaftësia ose vonesa e ndonjërës prej Palëve në ushtrimin e të drejtave apo mjeteve të ankimit në bazë të kontratës nuk do të interpretohet apo konsiderohet si heqje dorë prej tyre, dhe ushtrimi i vetëm apo i pjesshëm i një të drejte apo mjeti ankimi nuk do të përjashtojë ushtrimin e mëtejshëm të kësaj të drejte apo mjeti ankimi, sipas rastit. Të drejtat dhe mjetet e ankimit të parashikuara në Kontratë janë kumulative dhe nuk përjashtojnë të drejtat ose mjetet e ankimit të parashikuara me ligj.
- 20.4 Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës bëhet ose shpallet i jashtëligjshëm, i pavlefshëm ose i pazbatueshëm për çfarëdolloj arsyeje, ky kusht apo kjo dispozitë do të konsiderohet si i/e ndarë nga pjesa tjetër e Kontratës dhe si i/e hequr nga Kontrata, por gjithnjë me kushtin që, nëse kjo heqje prek apo tjetërsion në mënyrë të konsiderueshme bazën tregtare të Kontratës, Palët të negociojnë me mirëbesim për ndryshimin dhe modifikimin e dispozitave dhe kushteve të Kontratës, siç mund të jetë e nevojshme apo e dëshirueshme në rrethanat ekzistuese, për të realizuar në shkallën më të madhe të mundshme synimet fillestare. Kjo nuk do të cenojë vlefshmërinë e kushteve të tjera të Kontratës dhe vlefshmërinë e pjesës së mbetur të dispozitave në fjalë.
- 20.5 Nëse dorëzimi i Mallrave dhe/ose ofrimi i Shërbimeve do të bëhet me pjesë, Kontrata do të konsiderohet si një e vetme dhe jo si e ndashme.
- 20.6 Secila prej Palëve mban përgjegjësi për kostot e saj përkatëse ligjore dhe kostot e tjera të pësura në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e Kontratës.
- 20.7 Titujt në Kontratë janë vetëm për qëllime informimi, dhe nuk do të merren për bazë në interpretimin e saj.
- 20.8 Fjalët në njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe anasjellat, dhe fjalët e një gjinie të caktuar përfshijnë të gjitha gjinitë.
- 20.9 Hyrjet, klauzolat, paragrafët ose shtojcat u referohen hyrjeve, klauzolave, paragrafëve dhe shtojcave të Kontratës. Shtojcat përbëjnë pjesë të dispozitave operative të Kontratës dhe referencat ndaj Kontratës, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe në bazë të kontekstit, u referohen gjithashtu edhe hyrjeve dhe shtojcave.
- 20.10 Për të shmangur çdo dyshim, në rastin mospërfuthe midis dispozitave të Kushteve të Përgjithshme dhe dispozitave të kushteve të Urdhrit të Blerjes për sa i përket kuptimit, efektit ose interpretimit të tyre, Urdhri i Blerjes ka përparësi.
- 20.11 Referencat ndaj një ligji apo dispozite ligjore përbëjnë referencë ndaj versionit të ndryshuar, shtuar apo rimiratuar kohë pas kohe të këtij ligji apo të kësaj dispozite ligjore, së bashku me çdo akt nënligjor të nxjerrë kohë pas kohe mbi bazën e atij ligji apo dispozite ligjore.
- 20.12 Fjala “shkrim” apo “me shkrim” në përmbajtjen e kësaj Kontrate do të konsiderohet se përfshin emailin, por jo faksin.

- 20.13 Çdo fjalë që pason termat “duke përfshirë”, “përfshin”, “veçanërisht”, “për shembull” apo çdo shprehje të ngjashme, interpretohet si ilustruese dhe nuk kufizon kuptimin e fjalëve, përshkrimit, përkufizimit, shprehjes apo termit që paraprin këto terma.

21 Njoftimet

- 21.1 Çdo njoftim që duhet të bëhet në bazë të Kontratës jepet me shkrim dhe konsiderohet se është dhënë në mënyrën e duhur vetëm nëse (i) është dorëzuar personalisht, me postë rekomande ose me shërbime të postës ekspres, në çdo rast në selinë e Palës ose në vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit, ose në një adresë tjetër që Pala mund të ketë përcaktuar kohë pas kohe përmes një njoftimi me shkrim te Pala tjetër ose, sipas rastit (ii) me anë të emailit të certifikuar, ose (iii) me anë të transmetimit elektronik përmes sistemit elektronik të porosive të DHL-së. Palët dërgojnë gjithashtu kopje të çdo njoftimi përmes emailit te Pala tjetër, në adresën e emailit të specifikuar në Urdhrin e Blerjes, vetëm për qëllime informimi. Njoftimi nuk jepet apo nuk konsiderohet se është dhënë apo marrë nëse është dërguar vetëm me email, me përjashtim të rastit kur kjo është bërë me anë të emailit të certifikuar.
- 21.2 Çdo njoftim i tillë konsiderohet se është marrë nga marrësi dy ditë pune pas datës së dërgimit, nëse njoftimi ose dokumenti tjetër është dërguar me postë rekomande, ose në kohën e dorëzimit, nëse është dorëzuar personalisht.

22 Mbrojtja e të Dhënave

- 22.1 Secila Palë duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e zbatueshme të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave. Kjo klauzolë 22 i shtohet detyrimeve apo të drejtave të Palëve sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave, dhe nuk i shmang, anulon apo zëvendëson ato.
- 22.2 Furnitori përpunon të dhëna personale vetëm nëse dhe deri në masën që kjo është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të Kontratës. Në kryerjen e këtij përpunimi, Furnitori zbaton gjithashtu masat e duhura teknike dhe organizative që përmbushin kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave.
- 22.3 Furnitori siguron që punonjësit e tij të zotohen me shkrim se nuk do të përhapin tek askush të dhëna personale dhe informacione të tjera për të cilat ata vihen në dijeni si rrjedhojë e punës së tyre pranë DHL-së ose gjatë rrjedhës së kësaj pune, si dhe nuk do t'i përpunojnë këto të dhëna pa autorizim.
- 22.4 Nëse do të përpunohen të dhëna personale për llogari të DHL-së dhe në bazë të udhëzimeve të saj (marrëdhënia kontrollues-përpunues), palët do të lidhin një Marrëveshje Kontrollues-Përpunues (CPA). Në këtë rast, kushtet e Marrëveshjes Kontrollues-Përpunues kanë përparësi ndaj Kushteve të Përgjithshme lidhur me detyrimet e mbrojtjes së të dhënave sipas kësaj Kontrate, në rast të përplasjeve midis tyre.
- 22.5 Furnitori njofton menjëherë dhe plotësisht DHL-në me shkrim nëse janë përhapur të dhëna personale në shkelje të kësaj klauzole, të çdo dispozite tjetër të kësaj kontrate apo të legjislacionit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave. Në këtë rast, Furnitori ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të të dhënave personale. Për sa kohë që ato lidhen me objektin e Kontratës, Furnitori njofton menjëherë DHL-në për çdo inspektim, hetim dhe/ose masë administrative të ndërmarrë nga një autoritet mbikëqyrës (i mbrojtjes së të dhënave).
- 22.6 Në rast të shkeljes së kësaj klauzole, DHL-ja mund ta zgjidhë marrëdhënien kontraktore pa njoftim paraprak. Gjithashtu, Furnitori rimbursos DHL-në për çdo humbje ose dëmtim të shkaktuar si pasojë e shkeljes. Kjo përfshin kompensimin që u jepet punonjësve të DHL-së dhe rimbursimin e shpenzimeve të kryera si pasojë e prokurimit të një shoqërie tjetër.

23 Marrëdhënia midis Palëve

Furnitori dhe DHL-ja bien dakord se Kontrata nuk do të interpretohet si kontratë për krijimin e një bashkimi shoqërisht apo partneriteti ndërmjet DHL-së dhe Furnitorit. Palët bien dakord shprehimisht dhe kuptojnë se nuk ekziston asnjë marrëdhënie punëdhënës-punëmarrës ndërmjet DHL-së dhe Furnitorit apo ndërmjet DHL-së dhe ndonjë anëtarë të Personelit të Furnitorit, dhe se marrëdhënia me Furnitorin është e njëjtë me marrëdhënien me një kontraktor të pavarur për DHL-në.

24 Të drejtat e Palëve të Treta

- 24.1 Subjektet e DHL-së kanë të drejtën të vënë në zbatim çdo kusht të Kontratës. Me përjashtim të rasteve të përmendura në këtë klauzolë, Palët e Kontratës nuk kanë për synim që kushtet e saj të jenë të zbatueshme nga persona që nuk janë palë në të.
- 24.2 Palët ruajnë të drejtën për të anuluar apo ndryshuar Kontratën ose për të ndryshuar çdo kusht të saj pa pëlqimin e Subjekteve të tjera të DHL-së (me përjashtim të subjektit të DHL-së që është Palë e drejtpërdrejtë kontraktore e Kontratës, si dhe palë nënshkruese e saj).

25 Pajtueshmëria tregtare globale

25.1 Secila Palë deklaron, garanton dhe bie dakord se:

- 25.1.1 Do të respektojë plotësisht të gjitha ligjet e zbatueshme për tregtinë gjatë përmbushjes së Kontratës.
- 25.1.2 As ajo dhe as shoqëritë e saj kontrolluese, degët, agjentët, filiale, cesionarët nuk janë Persona të Kufizuar.
- 25.1.3 Nuk do të përfshijë Persona të Kufizuar apo Juridiksione të Kufizuara në asnjë cilësi, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, në asnjë pjesë të Kontratës dhe gjatë përmbushjes së Kontratës.
- 25.1.4 Nuk do t'i kërkojë Palës tjetër të ofrojë mallra dhe/ose shërbime që do të shkaktonin, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, shkelje të ligjeve të zbatueshme për tregtinë.

25.2 Furnitori pranon dhe është ekskluzivisht përgjegjës që:

- 25.2.1 T'i japë DHL-së informacion mbi klasifikimin e eksportit e kontrollit të eksportit dhe të gjitha kufizimet dhe kërkesat e zbatueshme të eksportit ose importit;
- 25.2.2 Të sigurojë dhe t'i japë DHL-së të gjitha autorizimet, licencat dhe lejet e kërkuara nga ligjet e zbatueshme për tregtinë. Nëse Furnitori ka marrë licenca eksporti nga autoritetet qeveritare përkatëse, Furnitori duhet t'i tregojë DHL-së juridiksionet që mbulohen nga këto licenca eksporti.
- 25.2.3 Të japë në kohën e duhur informacion të plotë, të vërtetë dhe të saktë, në formatin e specifikuar, në mënyrë që DHL-ja të ushtrojë kujdesin e saj të duhur që nevojitet për pajtueshmërinë tregtare.

25.3 Pavarësisht të gjitha dispozitave të tjera të Kontratës, secila Palë mund ta pezullojë ose ta zgjidhë menjëherë Kontratën, pa mbajtur asnjë përgjegjësi:

- 25.3.1 në rast të shkeljes ose mospërmbushjes nga Pala tjetër të ndonjë prej kushteve, deklaratave dhe angazhimeve të përcaktuara në këtë klauzolë; ose
- 25.3.2 në rast se ndonjë prej ligjeve për tregtinë pengon, kufizon ose ndalon përmbushjen e detyrimeve të ndonjërës prej Palëve sipas kërkesave të Kontratës.

25.4 Në shkallën e lejuar me ligj, secila Palë ("Dëmshpërblyesi") pranon të dëmshpërblejë dhe të mbajë të padëmtuar Palën tjetër për të gjitha dëmet, pretendimet dhe kostot e pretenduara nga palë të treta, duke përfshirë, por jo vetëm, tarifat e arsyeshme të avokatëve dhe të gjitha gjokat ose penalitetet nga autoritetet përkatëse, që rezultojnë nga shkelja me pakujdesi e kësaj klauzole nga ana e Dëmshpërblyesit.

26 Procedura e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve

- 26.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që burojnë nga Kontrata apo që kanë lidhje me të (me përjashtim të atyre që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme) i referohen fillimisht, nga secila Palë, personit përkatës të DHL-së që ka porositur Mallrat dhe/ose Shërbimet, si dhe menaxherit të kontratave të Furnitorit për zgjidhje. Kur është e nevojshme, DHL-ja dhe menaxheri i kontratave të Furnitorit negociojnë në mirëbesim për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve.
- 26.2 Nëse një mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet me negociim në mirëbesim midis DHL-së dhe menaxherit të kontratave të Furnitorit, ajo do t'i paraqitet për zgjidhje strukturave përkatëse të organizatave të Palëve, brenda një periudhe të arsyeshme pas referimit të saj. Nëse është e nevojshme, strukturat përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të negociojnë në mirëbesim për zgjidhjen e tyre.
- 26.3 Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet në bazë të klauzolës 26.2 më lart brenda një periudhe të arsyeshme pas datës së referimit, Palët mund ta referojnë çështjen për zgjidhje te një gjykatë në bazë të Kontratës.
- 26.4 Asnjërës Palë nuk duhet t'i ndalohet apo t'i shkaktohen vonesa në bërjen e një kërkesë për nxjerrjen e një vendimi për përmbushje specifike, ose për nxjerrje të një vendimi të ndërmjetëm apo të formës së prerë për marrjen e masave të sigurimit të padisë në interes të njëres palë, ose në mënyra të tjera si rezultat i kushteve të kësaj klauzole. Këto dispozita nuk zbatohen në lidhje me rastet kur kërkohen masa të tilla.
- 26.5 Përmbushja në bazë të Kontratës nuk ndërpritet apo vonohet për shkak të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në bazë të kësaj klauzole.

27 Legjislacioni dhe Juridiksioni Rregullues

- 27.1 Vlefshmëria, interpretimi dhe përmbushja e Kontratës rregullohet nga ligjet e vendit ku ndodhet selia e DHL-së. Përjashtim bën zbatimin i Konventës së OKB-së "Për Kontratat dhe Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave".
- 27.2 Kontrata i nënshtrohet në çdo kohë dhe përfshin automatikisht çdo akt ligjor të vendit ku ajo zbatohet dhe të detyrueshëm me ligj në vendin përkatës.
- 27.3 Gjykata kompetente e rrethit ku ndodhet selia e DHL-së ose (kur kjo lejohet nga ligjet e zbatueshme) çdo gjykatë tjetër kompetente e zgjedhur nga DHL-ja, ka juridiksion ekskluziv për të zgjidhur mosmarrëveshjet që mund të

burojnë nga Kontrata apo që kanë lidhje me të.
